



Npi – 01/435 datë: 27.11.2023

Duke u bazuar në nenin 12.2 shkronja (d) nenin, 17 shkronja (f) si dhe nenin 25 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040; Nenin 5.2 dhe 8.2 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr.03/L-087; Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e mbajtur më: 27.11.2023, mori këtë:

V E N D I M

PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT KOMUNAL TË AKSIONARËVE PËR K.R.M. “PASTËRTIA” SH.A. NJËSIA NË SHTIME

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -VIII- të rregullt për vitin 2023, të mbajtur më: 27.11.2023, me shumicën e votave miratoi, vendimin për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Aksionarëve për Kompaninë Rajonale të Mbeturinave “Pastërtia” SH.A. Njësia në Shtime.

II

Përbërja e Komisionit Komunal të Aksionarëve, është si vijon:

1. Bedri Zeqiri, - Rr. “Nënë Tereza” Nr.40 Shtime, (i emëruar nga Kryetari i Komunës)
2. Besnik Seferi – Rr. “Qamëria” Nr.169 Lagja Pajtimt (i zgjedhur nga Kuvendi)
3. Besiana Rashiti – Rr.”Nazim Bakiu” Nr.60 Petrovë (e zgjedhur nga Kuvendi)

III

- 4.1 Komisioni Komunal i Aksionarëve i përgjigjet Kuvendit Komunal mbi mënyrën e ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësisë të cilat u janë dhënë me Ligjin për Ndërmarrjet Publike.
- 4.2 Komisioni Komunal i Aksionarëve i raporton Kuvendit Komunal në bazë vjetore.
- 4.3 Mandati i anëtarëve të Komisionit Komunal i Aksionarëve zgjatë aq sa zgjatë mandati i rregullt ligjor i anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Shtimes.
- 4.4 Kuvendi i Komunës së Shtimes e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtarëve të Komisionit kur do herë që kërkohet.

IV

Me këtë vendim shfuqizohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Shtimes Npi – 01/149 i datës: 27.04.2023 për themelimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për KRM “Pastërtia” SH.A - Njësia në Shtime.

V

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në evidencën e protokollit zyrtar në MAPL, si dhe publikimi në Ueb – faqen zyrtare të Komunës së Shtimes.

VI

Me këtë vendim do të njoftohen: Arkivi, Anëtarët e Komisionit, Kryetari i Komunës, Drejtoritë, MAPL, dhe Zyra për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi